

Procedurat e aplikimit dhe të autorizimit të magazinave fiskale

1. Për qëllime të pikës 2 të nenit 20 të ligjit, miratimi për hapjen dhe shfrytëzimin e një magazine fiskale bëhet nëpërmjet një autorizimi të lëshuar nga autoritetet doganore.
2. Për marrjen e autorizimit të magazinës fiskale, kërkuesi aplikon pranë autoriteteve doganore me anë të një kërkesë tip sipas formularit të aneksit 11 të këtij vendimi.
3. Kërkesa për marrjen e autorizimit të magazinës fiskale i drejtohet zyrës doganore territorialisht kompetente të vendit ku ndodhet magazina e prodhimit, përpunimit apo stokimit/depozitimit të produkteve të akcizës.

“4. Kërkesës tip duhet t’i bashkëlidhen dokumentet e mëposhtme:

- a) Ekstrakti historik nga QKR-ja;
- b) Prokura e përfaqësuesit ligjor për marrjen përsipër të përgjegjësive të shoqërisë, për rastet kur nuk përcaktohet në ekstraktin e QKR-së;
- c) Dëshmi penaliteti e përfaqësuesit të shoqërisë/administratorit;
- ç) Planimetria e ambienteve të planifikuara për magazinë fiskale, të shoqëruara me foto për çdo plan si brenda ashtu edhe jashtë;
- d) Plani dhe përshkrimi i instalimeve të ndryshme që do të jenë pjesë e magazinës fiskale (instalime, depo, rezervuarë, tubacione etj.);
- dh) Akti i kalibrimit të kontejnerëve (depozitave, sillosa etj.) nga DPM-ja, në rastet kur do të depozitohen lëngje apo materiale rifuxho. Për rastet kur marrja e certifikatës së kalibrimit është në proces, të depozitohet kërkesa e aplikimit shoqëruar me certifikatat e kalibrimit të disponueshme në momentin e prodhimit/importit;
- e) Certifikimet përkatëse për instrumentet dhe pajisjet matëse nga DPM-ja;
- ë) Deklarata për natyrën dhe pozicionin tarifor të produkteve që priten, dërgohen, mbahen dhe në rastin e magazinave të prodhimit edhe të lëndëve të para dhe produkteve të prodhuara;
- f) Karta teknologjike me parametrat e punës, lëndët e para dhe produktet përfundimtare të përfituara sipas standardeve të përcaktuara më parë;
- g) Vlerësimi i sasive të produkteve të akcizës të prodhuara, të përpunuara dhe të depozituara/të stokuara për një periudhë të caktuar (vjetore apo që mbulon aktivitetin nëse është sezonale);
- gj) Dokumenti i garancisë;
- h) Informacioni për sistemin kontabël që përdor shoqëria, si dhe masat e kontrollit të brendshëm e metodat e kontrollit që ajo përdor;
- i) Konfirmimi se shoqëria nuk ka asnjë detyrim të pashlyer ndaj administratës doganore në momentin e aplikimit.”.